



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 228/23

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 16.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28, paragrafi 1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24, paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 tetor 2023 (e enjte) me fillim në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i proceverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 26 shtator 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i proceverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 28 shtator 2023;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit nëntëmujor të shpenzimeve për periudhën janar – shtator 2023;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft – Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024 – 2032;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore të punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2023;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” Sh.a në Vushtrri;
9. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi <i>Melihate Basholli Latifi</i>
TEMA:	Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 13.10.2023

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2023 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor të shpenzimeve për periudhën janar – shtator 2023.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft – Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024 – 2032.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të plotësohet kjo informatë nga Drejtoria për Shërbime publike, ku të kemi informacione se si është gjendja e furnizimit me ujë të pijes dhe si është gjendja me zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit për vitin 2023 dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore të punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2023.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që t'i bashkëngjitet lista e ndarjes së subvencioneve dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. *KPF-ja rekomandoi:*

Që të procedohet në kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, raporti i komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes "Përparimi".

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 SHTATOR 2023

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 9:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Agim Bregaj, Alban Bajrami, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Adnan Lahu, Agron Perçuku, Spasoje Stefanovi, Ali Januzi, Edona Gashi, Gentiana Rama, Mek Selaci dhe Shkelzen Xhaferi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 27 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme.

Në nderim të rënies heroike të rreshterit Afrim Bunjaku, tani Hero i Kosovës u mbajt një minutë heshtje.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës –Ai tha se këto dy ditë kemi pasë dhimbje dhe mërzë, me rastin e rënies së heroike të rreshterit Afrim Bunjaku, i cili është heroi më i ri i Kosovës. Edhe bota demokratike u solidarizua me neve, sepse ai ra në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës. Komunës së Vushtrrisë iu bënë dy heronj nga Policia e Kosovës që ranë në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës: Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku. Dua të ju njoftoj se në seancat e ardhshme do t'ua sjelli një propozim për emërimin e shëtitores me emrin e Afrim Bunjakut, ku do t'i bashkëngjitet pjesës tjetër të shëtitores që mban emrin e Enver Zymberit.

Arsyeja pse e kemi caktuar këtë seancë të jashtëzakonshme është për arsye që ta trajtojmë projekt-buxhetin më në detaje dhe të shikojmë bashkërisht se mos kemi harruar projekte të rëndësishme

pa u përfshi. Edhe pse jemi munduar që ti marrim inputet nga qytetarët përmes dëgjimeve buxhetore, grupeve të ndryshme të interesit, shoqërisë civile, klubeve të sportit, grupet e grave, etj. Pra, jemi munduar që të jemi gjithpërfshirës, por nuk do të thotë që e kemi bërë më të mirën dhe nuk kemi lënë zbrazësira, në mënyrë që në kuvend ju t'i paraqitni propozimet e juaja

Idrizi në pika të shkurtra prezantoi projekt – buxhetin, ku tha se ka subvencione më shumë në të gjitha fushat se buxheti i këtij viti. Gjendja e rëndë ekonomike-sociale po na imponon që të ndahen më shumë subvencione. Sa i përket investimeve kapitale, jemi munduar të jemi më gjithpërfshirës në qytet dhe fshatra. Ai tha se prioritet i kemi dhënë ujësjellësit, ku fshatrat e pjesës lindore të Komunës së Vushtrrisë janë shumë keq, ku kemi ndarë një buxhet solid për atë pjesë, i bazuar në propozimet e ekspertëve të ujësjellësit, të cilët na kanë sugjeruar të ndërtojmë bazenet e ujit dhe përfundimisht të zgjidhet çështja e ujit të pijes.

Po ashtu, si prioritet i kemi dhënë investimeve në shkolla nëpër fshatra, në mënyrë që të pengohet migrimi në qytet, pasi që në fshatra ekziston rreziku i mbylljes së shkollave në mungesë të nxënësve, kurse në qytet kemi mbingarkim të numrit të nxënësve. Por, kemi planifikuar edhe investime në shkollat e qytetit dhe çerdhe. Ai tha se është bërë planifikimi i renovimit të shkollës “Migjeni” dhe janë ndarë mjetet për shndërrim në çerdhe.

Idrizi deklaroi se lidhur me sallën e sporteve të shkollës SHMU2 ka biseduar me Ministrinë e Arsimit, pasi që është projekt i saj, na kanë njoftuar që ne mos të planifikojmë mjete, sepse së shpejti ministria do ta shpallë tenderin për atë projekt.

Kemi planifikuar që ta fusim në investime rrugën e Studimet, ku vlera e saj është mbi 2 milion euro, e cila do të rregullohet sipas standardeve.

Është planifikuar edhe riasfaltimi i vijave kryesore të rrugëve. Kurse, si problem që na ka dalë gjatë planifikimit të projekt-buxhetit është se kemi disa rrugë që janë pronë private. Prandaj, duhet të kemi kujdes edhe të propozimet që ua kanë dhënë banorët, që fillimisht të definohet prona dhe nëse është private, të shndërrohet në pronë publike.

Ajo që kisha kërkuar nga ju anëtarë të kuvendit është se ta analizoni këtë projekt – buxhet në detaje, jepni propozimet e juaja dhe në fund ju bëj thirrje që ta votoni.

Kuvendi i Komunës me 26 vota “për” aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi i Projekt – buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025 – 2026.

Faton Hyseni, anëtar i KK-së – sa i përket këtij draft-buxheti, shihet që është shumë i përgjithshëm, nuk janë specifikuar siç duhet investimet dhe lokacionet. Kjo me dashje ose nga pakujdesia lë hapësirë për manipulim nga niveli komunal, me kërkesat e qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit, si dhe krijon hapësirë për keqpërdorim. Psh. ndërtimi i rrugëve nëpër fshatra, ndërtimi i rrugëve në qytet. Cilat rrugë? A kanë emra ato rrugë? Ku gjenden saktësisht? A janë kërkuar nga banorët ato rrugë? Nëse po, cilat janë ato? S’ka nevojë me lënë hapësirë, sepse të gjitha janë të emertuara. Në lokacionin nga vij unë quhet Stanoc i Epërm. Ekziston edhe Stanoci i Poshtëm. Kurse, në draft – buxhet e kemi shkruar “ndërtimi i fushave sportive në Maxhunaj, Lumadh e Stanoc”. Në cilin Stanoc? Çfarë fushe, sepse ka lloj-lloj fusha sportive. Andaj, ky draft – buxhet nuk pasqyron kërkesat e qytetarëve të paraqitura, sidomos në dëgjimet e fundit buxhetore. Si i tillë, është shumë i përgjithshëm dhe nuk specifikon investimet, lokacionet dhe emërtimet e sakta. Po ashtu, linjat investive janë të njëanshme. Prandaj, si i tillë nuk mund ta ketë mbështetjen

time. Nuk mund ta votoj një buxhet, që në shkollën ku punoj mbi 30 vite, prej qeverisjes së Xhafer Tahirit nuk është investuar as edhe një gozhdë, e le mos të flasim për aneks që e kam cekur që disa herë. Nuk mund ta votoj një buxhet, që nuk parashihen mjetet për shndërrimin e ish objektit të shkollës në çerdhe të fëmijëve, sipas vendimit që është marrë në këtë kuvend. Tash e ceku kryetari, por nuk është në material dhe nuk ceken mjetet financiare për këtë çerdhe. I ftoj të gjithë asamblastët që vijnë nga ajo trevë (Stanoc i Epërm): Agim Bregaj, Ymer Haradinaj, Mensur Kasumi, që mos ta votojnë këtë draft – buxhet dhe që mos të anashkalohen projektet tona. Investimet kapitale janë 7 milion, kurse ne si trevë jemi 8% e banorëve të Komunës së Vushtrrisë, që do të thotë se na takojnë që të kemi investime gjysmë milion euro. Ndërsa, në anën tjetër thojnë krejt mjetet po i dërgojnë në Stanoc. Nuk i çojnë në Stanoc, por po na i vidhni dhe po i jepni orientim të kundërt. Paret që vijnë nga qeveria, vijnë për kokë banori.

Si i tillë, nuk e ka mbështetjen time ky draft – buxhet. Nëse mbes edhe i vetëm, edhe nëse 34 votojnë për, vota ime do të jetë kundër.

Sylejman Mehulli, anëtar i KK-së – sot jemi në një seancë të jashtëzakonshme dhe në rrethana të jashtëzakonshme si republikë dhe si komunë për shkak të situatës në veri dhe rënies së heroit Afrim Bunjaku në mbrojtje të sovranitetit, që ne si grup kuvendar i shprehim mirënjohjen dhe respektin e thellë për kontributin shtetëror. Në rrethana të tilla nuk është e lehtë të debatosh për buxhetin që na ka rastis ta kemi në këto rrethana. Nuk mund ta kalojmë një buxhet të tillë si grup kuvendar, as në këto rrethana, për shkak se ky buxhet nuk meriton të kalohet si i tillë dhe këtë buxhet nuk e meritojnë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Ky draft- buxhet na ka ardhur me ndryshime të vazhdueshme deri mbrëmë, duke ndryshuar analitika, specifika dhe kode të caktuara buxhetore. E tha edhe parafolësi, ky draft-buxhet nuk është i specifikuar. Ai tha se është lajm i mirë që janë rritur subvencionet nga qeveria për komunën tonë, si dhe investimet kapitale janë rritur. Megjithatë, qeveria lokale nuk ka arritur për këtë periudhë të na e sjell një buxhet që ish dashur të jetë sot festë këtu, duke e kaluar një buxhet zhvillimor, që i jep kahje zhvillimit të Vushtrrisë dhe një buxhet që asnjëherë s'ka qenë 7 milion euro për investime kapitale. Ju bëj thirrje asamblastave që ta printojnë buxhetin e vitit të kaluar dhe një pjesë e madhe e projekteve kapitale që kanë qenë të planifikuara që të kryhen për këtë vit, prapë janë sjell në këtë draft-buxhet. Ende nuk kemi përgjigje se çfarë ka ndodhur me ato projekte. Shpresoj që ato mjete nuk kanë shkuar suficit dhe ne prapë do i fusim ato projekte. Kjo po i bjen që Vushtria në dy vite po e humb një vit të plotë buxhetor. Kjo është një ngecje e jashtëzakonshme.

Po ashtu, mungojnë specifikat e rrugëve, që u cek më herët, mungon gjatësia e rrugëve, mungojnë lagjet, fshatrat. Në shumë vende, duke kamufluar se po i prekim të gjitha fshatrat, planifikohen shuma qesharake, kurse futen në pako disa fshatra, psh: Ndërtimi i kanalizimit në Maxhunaj, Ropicë, Vilanc, Samadrexhë, Ceceli, Sllakoc. Përveç që është vështirë ta planifikosh të njëjtin kanalizim në aspektin gjeografik, për gjashtë fshatra planifikohen 82 mijë euro. Nëse këtë shumë e pjesëtojmë me gjashtë e shihni se me sa mjete mund të kryhet një investim i tillë. Ndërtimi i kanalizimit në Dumnicë, nuk dihet cila Dumnicë. Pastaj, kemi një planifikim enorm në dy rrugë të qytetit: Rruga “Lumni Surdulli” dhe rruga “Bekim Berisha (Abeja)”, ku të dyja bashkë janë 900 mijë euro dhe afër 800 mijë euro në sheshin e qytetit, bulevardi “Adem Jashari”. Kurse, në anën tjetër, kemi plot fshatra, që arteriet kryesore janë në gjendje të mjerueshme, e mos të flasim për rrugë të lagjeve e fshatrave.

Janë pesë fshatra te riasfaltimi i rrugëve në vlerë 45 mijë euro, që po i bie 9000 euro për fshat. Çfarë riasfaltimi mund të bëjmë me 9000 euro. Pastaj, ndërtimi i rrugëve lokale në Dumnicë,

Maxhunaj, Stanoc i Epërm, Lumadh, Vilanc, Ropicë, Pestovë në vlerë 20 mijë euro. Janë 7 fshatra e që i bie më pak se 3000 mijë euro për fshat.

Në shëndetësi është pothuajse e njëjtë me të vitit të kaluar dhe nuk e dimë se çka ka ndodhur me këto investime. Ne si grup kuvendar nuk mund ta votojmë këtë buxhet se nuk është i duhur dhe kërkoj që të gjithë asamblistët të jenë në nivel të detyrës.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – u përmendën dy rrugët “Lumni Surdulli” dhe “Bekim Berisha (Abeja)”, është e vërtetë që kanë investime, por ato janë bërë me projekte detaje dhe aq është vlera e investimeve. Për mua rruga “Bekim Berisha (Abeja)” është arterie kryesore dhe nyje strategjike, sepse ka qasje në autostradë dhe në atë pjesë janë kompanitë më të fuqishme që e bëjnë transportin e mallrave dhe kanë shumë nevojë të kenë qasje në autostradë. Kurse, rruga “Lumni Surdulli” është një arterie e fuqishme që e zbraz një pjesë të madhe të qytetit të Vushtrrisë që shkon në drejtim të fshatit Nedakoc. Pastaj, rruga “Avni Saraçi” është një imazh në hyrje të qytetit dhe që duhet të rregullohet.

U përmendën rrugët nëpër fshatra, me qëllim i kemi futur në atë mënyrë, sepse nuk kanë mbetur edhe shumë rrugë pa u asfaltuar.

Prandaj, ju bëj thirrje që ta votoni buxhetin, sepse është për të gjithë qytetarët e Vushtrrisë

Sylejman Mehulli, anëtar i KK-së – tha se kudo që asfaltohen rrugë, ne e mbështesim. Megjithatë, buxhetin që e ke sjell kryetar, nuk është i duhur dhe sa më parë që e kupton këtë është në të mirën tënde dhe të qytetarëve.

Fatmire Cecelia, anëtar i KK-së – deklaroi se sot jemi thirr në këtë seancë të jashtëzakonshme për ta miratuar buxhetin për vitin 2024 – 2026, konkretisht për vitin 2024. Për ta përgatitur këtë draft iu është dashur shumë kohë, bile për me punu më qetë keni shkuar edhe në Shqipëri dhe keni ardhur në përfundim pa bërë asgjë. Kjo e dëshmon vetë ndërrimi i buxhetit për disa herë brenda një jave. I nderuar kryetar, ke pasë filluar me gojën plot për arsim, rini e urbanizëm dhe në këtë draft-buxhet nuk keni paraparë asgjë për rini, për arsim pak e hiç. Tek drafti i parë, Drejtoria për Arsim i ka pasur të planifikuara 900 mijë euro, kurse te drafti i fundit që na ka ardhur i ka 490 mijë euro. Është fatkeqësi kur kaq shumë përgjysmohet buxheti në Drejtorinë për Arsim. Është planifikuar ndërtimi i shkollës “Bahri Kuqi”, kurse nuk keni planifikuar buxhet. Mirë që ju kish ra në mend që në draftin e fundit keni planifikuar diçka për arsimin parafillor. Ndërtimi i çerdhes është vlera 60 mijë euro. Për cilën çerdhe është fjala? Rregullimi i dhomave për parafillor. A është fjala për dhomat e parafillorëve në shkolla apo çerdhe?

Kopshti “Foleja 2” është një objekt dy kat dhe nuk ka shkallë emergjente. Çuditërisht askujt nuk i bie ndërmend për sigurinë e fëmijëve tanë.

Tek Drejtoria për Shërbime Publike, janë bërë planifikime për ndërtimin e kanalizimeve, kurse nuk janë specifikuar se në cilat vende do të ndërtohen. Du t’ju pyes, se pse prej 24 kodeve buxhetore, vetëm një rrugë e ka emrin, “Niman Ferizi” për ndërtim të kanalizimit. E njëjta rrugë ka hy në planifikim edhe për kubëza betoni dhe nuk kishit planifikuar fare buxhet. Ku janë paraparë ndërtimet e shtigjeve për ecje dhe biciklist?

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kurrë më keq nuk ka qenë. Në draftin e parë të buxhetit i ka pasur 430 mijë euro, kurse në draftin e fundit vetëm 160 mijë euro. Me 30 mijë euro nuk mund të bëni asgjë në restaurimin dhe konzervimin e objektit “Arkivi i vjetër” – ish fabrika e vajit, se ky projekt kushton më shumë. Pastaj, renovimi i platosë në Kalanë e qytetit, për këtë duhet të bëni kërkesë, sepse këtë objekt e rregullon Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, e jo komuna, e cila

është vetëm menaxher i kalasë. Është viti i tretë që nuk e keni ndarë asnjë cent për muzeun e qytetit që njihet si shtëpia e Mahmut agë Gjinollit, i cili është duke punuar ilegalisht, sepse nuk ka pranim teknik.

Te stadiumi “Ferki Aliu” ju kisha sugjeruar që ti mbulonit tribunat te zhveshoret, sepse kanë filluar të demolohe.

Prandaj, trajtoni qytetarët në mënyrë të barabartë, mundohuni t’ua përmirësoni kushtet e infrastrukturës të gjithë banorëve, e jo vetëm militantëve.

Faton Hyseni, anëtar i KK-së – kryetari na tha që paraqitni kërkesat. Kryetar tregoj qytetarëve edhe asamblistëve tuaj se unë nuk di të bëjë kërkesa private. Kërkesat i bëj me shkrim dhe me datën 11.09.2023 i kam bërë tri kërkesa për tri fshatra, e jo kërkesa të mia, të cilat ja kam drejtuar kryetarit dhe kryesueses.

Bekim Zabërgja, anëtar i KK-së – tha se do të flas shkurt dhe qartë për draft – buxhetin për vitin 2024. Buxheti për investime kapitale është 6,926,738.00 euro. Ky buxhet, këto investime kapitale këto dy vitet e fundit është buxheti më i mirë i mundshëm, për shkak se janë përfshirë të gjitha fushat ekonomike. Prandaj, këto mjete i kemi në dispozicion dhe secili prej jush le të bëhet kryetar apo drejtor dhe të na tregoj se ku me i shpërnda. Prandaj, këto mjete janë shpërndarë në mënyrën më të mirë të mundshme. Kam qenë në terren dhe e kam parë në fshatra dhe qytete se 98% e rrugëve kryesore janë të asfaltuara. Unë kam propozuar vetëm segmente të rrugëve për asfaltim, sepse rrugët kryesore janë të asfaltuara. Prandaj, çdo fushë e jetës ekonomike dhe sociale është përfshirë. Ai tha se e kemi obligim që ta votojmë buxhetin, sepse qytetarët presin nga ne si përfaqësues të tyre që ta votojmë buxhetin dhe mos ti lëmë ata pa investime. Prandaj, ai ftoi anëtarët e kuvendit që ta votojnë buxhetin, ashtu siç kemi votuar vitin e kaluar (në mënyrë unanime), sepse tha se është më i miri i mundshëm për shkak të mundësive buxhetore që ka komuna.

Alban Bajrami, anëtar i KK-së – deklaroi se sot po e paraqes interesimin e komunitetit sportiv dhe qytetar për meremetimin e fushës sportive “Musa Abazi”, e cila gjendet afër parkut të qytetit. Ajo fushë ka filluar të renovohet në fund të vitit 2021 dhe që nga ajo kohë nuk është filluar të investohet asgjë dhe ka mbetur ajo punë e papërfunduar. Ajo fushë paraqet një simbolikë të veçantë, sepse aty janë zhvilluar turne të karakterit lokal dhe nacional. Vlen të ceket mbajtja e turneut në futboll të vogël apo futsall, ku tubonte të gjithë futboll dashësit e të gjitha qyteteve të Kosovës, me një pjesëmarrje prej 2000-3000 shikues. Pastaj, garat në hendboll si për meshkuj ashtu edhe për femra.

Behar Duraku, anëtar i KK-së – dua t’i shpalos disa kërkesa që kanë dalë si rezultat i dëgjimeve buxhetore, ku në dy takime isha i pranishëm edhe unë: Në Stroc dhe Druar- që përfshihen tetë fshatra. Në Mihaliq, rruga për ndriçim 600 m, kanalizimi në lagjën “Bunjaku”, kanalizimi në rrugën “Çlirimi”, ndriçimi në rrugën kryesore në Mihaliq – “Shaban Kapuçi” – 600m, rregullimi i rrugës “Çlirimi”. Pastaj, në Bukosh, asfaltimi i rrugës “Mehmet Kollari” – 150m, pastaj rruga “Gani Hajrizi”. Në Stroc, shtrimi i trotuarit nga shkolla e Strocit në gjatësi 1km, rruga “7 Dëshmorët”. Asfaltimi i rrugëve: “Halim Aliu” 100m, asfaltimi i rrugës “Lan Aliu” 100m, asfaltimi i rrugës Armend Aliu” 50m, asfaltimi i rrugës “Nexhmedin Duraku”, asfaltimi i rrugës “Sahit Duraku”, asfaltimi i rrugës “Xhafer Duraku”, asfaltimi i rrugës “Arben Duraku”, asfaltimi i rrugës “Kadri Duraku” 50m, asfaltimi i rrugës, segmenti “7 Dëshmorët” 50m, asfaltimi i rrugës

“Lan Aliu”, rruga e Përparim Aliut 100m, asfaltimi i rrugës “Lan Aliu”, rruga e Mexhid Duraku 100m. Pastaj, në fshatin Beçuk, asfaltimi i rrugës “Rexhep Murati” 400m, asfaltimi i rrugës “Jahir Murati” 400m, ndriçimi në rrugën “Avdyl Haliti” 300m, kanalizimi në rrugën “Abdyl Haliti” dhe “Faton Syla” me gjatësi totale 600m.

Në fshatin Gllavat, rregullimi i hapësirës së monumentit të Batalionit të Parë të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës të UÇK-së, asfaltimi i rrugës “Rexhep Konjuhi” 100m, asfaltimi i rrugës “Driton Islam Hasani” 100m.

Në fshatin Bivolak, asfaltimi i rrugës “Nazif Klinaku” 50m, asfaltimi i rrugës “Berishaj” 60m, asfaltimi i rrugës “Imer Saraçi” 100m.

Në fshatin Zhilivodë, asfaltimi i rrugës “Ahmet Krasniqi”, rrugica Lutaj 150m, si dhe rregullimi i kanalizimit.

Ymer Haradinaj, anëtar i KK-së – sot jemi në një seancë të jashtëzakonshme dhe në një gjendje të jashtëzakonshme, për shkak të zhvillimeve që kanë ndodhur ditëve të fundit dhe me këtë rast i shprehu ngushëllimet më të sinqerta familjes së heroit, Afrim Bunjaku.

Dy vitet e para të qeverisje suaj, e kemi votuar buxhetin në mënyrë unanime. E kemi votuar buxhetin në mënyrë që ta shohim se cilat janë prioritetet tua si kryetar i komunës, por edhe të partisë tuaj. Vitin e kaluar kemi paraqitur kërkesat në këtë kuvend që na është thënë se do të merren parasysh, e që nuk janë marrë parasysh. Kjo punë duhet analizuar dhe që ka ndoshta ka punë edhe për organet e drejtësisë. Ky buxhet nuk është gjithëpërfshirës në aspektin gjeografik dhe si i tillë nuk meriton përkrahje. Vitin e kaluar janë larguar kiflet për nxënës, ne kërkojmë që të futen në këtë draft.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi me 16 vota “për”, 7 “kundër” aprovoi buxhetin për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025 – 2026, për këtë pikë u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2024-2026, konform Qarkoreve Buxhetore 2024/01 dhe 2024/02 për komuna të lëshuara nga MFPT-ja, për vitin 2024 dhe projektionet për vitet 2025 dhe 2026.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024 është **26,770,039.00 €**, prej të cilave për:

	Kategoritë buxhetore	2024	2025	2026
1.	Paga dhe mëditje	13,209,301.00 €	13,248,929.00 €	13,288,676.00 €
2.	Mallra dhe shërbime	4,840,000.00 €	4,902,920.00 €	5,035,299.00 €
3.	Shpenzime komunale	571,000.00 €	612,683.00 €	652,507.00 €
4.	Subvencione	1,223,000.00 €	1,333,070.00 €	1,413,054.00 €
5.	Shpenzime kapitale	6,926,738.00 €	8,071,569.00 €	9,182,130.00 €
	Totali:	26,770,039.00 €	28,169,171.00 €	29,571,666.00 €

3. Të hyrat vetanake të planifikuara.....3,418,154.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 2024/01 dhe 2024/02 të MFPT-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitet 2024-2026, (kopja e shtypur prej SZHMB, të vulosura si dhe nënshkruar nga kryetari i komunës dhe ZKF). Tabela 4.2 – financimi i projekteve kapitale për vitin 2024 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitet 2024-2026 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF-ja). Tabelat 4.3 plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga kryetari i komunës dhe ZKF-ja), si dhe tabelat e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

Mbledhja përfundoi në orën **10:40**.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VIII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 SHTATOR 2023

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mungoi: Spasoje Stefanoviq.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Në fillim të mbledhjes kuvendi nderoj me 1 (një) minutë heshtje doktorin dhe veteranin e mjekësisë tashmë i ndjeri Dr. Shukri Gërxhaliu.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –apeloj dhe e kontestoj ligjshmërinë e mbledhje, duke shtuar në adresës të kryesuese së kuvendit se e njëjta nuk ka të drejt të procedoj me zhvillimin e punimeve të seancës së sotme plenare, pasi që mbledhja e rregullt e muajt korrik është ndërprerë dhe e njëjta ka mbetur e pa përfunduar, andaj tërhiqi vërejtje se nuk mund të mbahet mbledhja e ditës së sotme pa u përfunduar mbledhja e korrikut, sepse kjo bie ndesh me ligjin

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-akordoj një pauzë prej 15 minuta për të konsultim dhe për të marr mendimin e MAPL-së, se a mund të zhvillohet mbledhja e kuvendit.

Kryesuesja e kuvendit konstatoj se pasi ka marr mendimin dhe konsultimet e nevojshme me Departamenti Ligjor në MAPL, të njëjtit i kanë sugjeruar dhe shpjeguar se mbledhja e mbetur në gjysmë duhet të vazhdohet në bashkëpunim me anëtarët e kuvendit, ndërsa

mbledhja e ditës së sotme është krejtësisht në suaza të ligjit dhe njëjta mund t'i zhvilloj punimet.

Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit-propozoi që të shtohet një pikë në rendin e ditës dha atë propozim-vendimi për caktimin e lokacionit apo ndarjen e një parcele për ndërtimin e Lapidarit për Dëshmorin Hamdi Hajrizi nga fshati Stroc. Ky propozim është edhe kërkesë e banorëve të fshatit Stroc konkretisht banorët në rrugën Zymer Hajrizi, kërkohet të sigurohet vetëm parcela ndërsa lapidari i dëshmorit do të bëhet me mjete vetanake po vetëfinancim.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se e mbështet propozimin e parafolës së tij, por ceku se duhet respektuar dispozitat e statutit të komunës kur bëhet fjalë për cekimin dhe ngritjen e lapidarëve për dëshmoret dhe pllakave dhe përmendoret tjera.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –tha se ka gati tri apo katër mbledhje që kërkon të silltet në kuvend ndryshim-plotësimi i rregullores për taksa për bizneset, kur dihet fakti se bizneset janë duke operuar në një gjendje jo të mirë, dhe si pasoj ka edhe mbyllje të bizneseve që janë sheshin e qytetit.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-ngriti shqetësimin e disa banorëve lidhur me bizneset që i shfrytëzojnë lokalet tek Xhamia e Qarshisë, që janë në pronësi të BIK-ut, të njëjtat kanë bërë kërkesë për legalizimin e tyre por që një gjë e tillë nuk po ju mundësohet, apo legalizimi është bërë në mënyrës selektive. Mandej pyeti Drejtorin e Inspektiveve se si kanë operuar disa lodra për fëmijë tek rr. Ismaj Qemajli si biznes por që nuk kanë pasur leje për operim.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –pyeti se kryetarin e komunës, se ku është Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, i cili nuk është prezent në mbledhje, i njëjti a ka dhënë dorëheqje apo është larguar me shkarkim. Pastaj kryetari i komunës a është i kënaqur me punën e tij dhe si e vlerëson performancën që ai e ka pasur si drejtor. Më tej shtoi se është tepër keq votimi i buxhetit për DSHP-në, pasi që po përgatitet një teren jo i përseshëm edhe për drejtori e ri njëfarë forme po i minohet terreni i operimit dhe do ta ketë shumë vështirë në realizimin e projekteve në shëndetësi.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –vlerësoi se pa dashur të polemizon me parafolësin, ceku se tendenca e pasuar për gjoja minimin e DSHP-së dhe punës së saj është e paqëndrueshme, sepse e gjithë politika zhvillimore në DSHP por edhe në drejtoritë tjera me legjislacionin lokal i takon kryetarit të komunës, dhe këtë është dashur ta di edhe ish-drejtori i DSHP-së z.Meholl dhe kjo ndoshta edhe do të kishte ndihmuar në arritjen e rezultateve me të mira në punën e tij. Ai falënderoj ish-drejtorin z.Rashica për punën që ka bërë për angazhimin dhe rezultate e arritura në fushën e shëndetësisë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-s qaroi se tashmë ish drejtori i Shëndetësisë në Vushtrri, ka bërë kërkesë me shkrim për lirim nga detyra e drejtori, për shkak të angazhimeve të tij personale dhe familjare, dhe një gjë e tillë si kryetar i komunës i'a ka konfirmuar duke i mirëkuptuar dhe falënderuar në të njëjtën kohë për bashkëpunimin dhe kontributin që ka dhënë z.Nexhmedin Rashica Drejtoi i Drejtorisë për Shëndetësi, pra nuk kemi të bëjmë me shkarkim të tij por i njëjti ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Lidhur me mendimin se është minuar buxheti kjo është e paqëndrueshme për faktin se planifikimi i buxheti ka filluar në një fazë shumë më të hershme kur ka ardhur qarkorja e parë buxhetore në muajin maj 2023.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 33 vota “për” 1 votë “abstenim” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 24/22 i datës 31.01.2022;
2. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje – shirjeve për vitin 2023;
3. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë, nëntor – dhjetor 2022 dhe janar – shkurt – mars 2023;
4. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi publik me qytetarë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomike - financiare dhe zbatimin e planeve investuese janar - qershor 2023;
6. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Ismail Qemajli” në Vushtri;
7. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Ismail Qemajli” në Vushtri;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e sallës së sporteve “Afrim Bunjaku” në Samadrexhë;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e mbështetjes financiare familjes së Heroit të Kosovës të z.Afrim Bunjaku;
12. Rishqyrtimit i Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
13. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 24/22 i datës 31.01.2022;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –duke ju referuar një procesverbalit të Komisionit për Siguri në Bashkësi, ceket se në takim është zgjedhur kryesia e këtij komisioni me kryetar Blerim Ibrahimimi dhe nënkryetar Arbër Hoxha, dhe shtoj se kjo nuk ka kuptim që një kryesi të përbëhet vetëm nga kryetari dhe nënkryetari (d.m.th. kryesia nuk përbëhet vetëm me dy anëtar por duhet të jetë edhe të paktën sekretari). Kërkoj që kjo të plotësohet dhe kjo pikë të shtyhet për aprovim në mbledhjen tjetër të kuvendit me plotësimet e duhura.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se këto zëvendësime në KKSB, po bëhen me pozitat sipas detyrës zyrtare, dhe kuvendi nuk duhet të silllet si bllokues i punës së këtij trupi, andaj kërkoj të procedohet për aprovim ky propozim-vendim.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 24 vota “për” 7 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si në vijim:

1.1 Në pikën 1.14 Sedat Durmishi, përfaqësues i Komunitetit Ashkali, shkarkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së.

1.2 Në pikën 1.15 Brendon Shaqiri, përfaqësues i komunitetit rom, shkarkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së.

1.3 Në paragrafin 1, pika 1.3 Miradije Maloku, ish Drejtore e Drejtorisë për Arsim, pushon të jetë anëtare e KKSB-së.

1.4 Në pikën 1.10 Simo Çimburowiç, përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe, pushon të jetë anëtar i KKSB-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

2. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje – shirjeve për vitin 2023;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se kjo informatë është shqyrtuar në KPF, dhe ka qenë mendimi i përgjithshëm që kjo informatë të plotësohet sepse është tepër e cunguar dhe e mangët, por si shihet prapë është proceduar në të njëjtën formë duke mos u respektuar rekomandimi i Komitetit për Politikë dhe Financa nga ana e drejtorisë së linjës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se kjo informatë është punuar vetëm në shtylla të përgjithshme ndërsa, drejtorja është në përgatitje e sipër të një raporti më të detajuar për mbledhjen e ardhshme.

Ergyn Sunguri, drejtor i DEBPZHR- paraqiti sqarimet e nevojshme duke ju përgjigjur çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se informatë ka gabim në adresim të organit, mirëpo e njëjta ka të dhëna të sakta. Ajo çka është shqetësues është fakti se kjo verë ka qenë jo produktive dhe me rendimente tepër të ulëta e që bujqit tanë sigurisht se janë të dëmtuar.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –tha se qeveria komunale dhe kryetari i komunës duhet të mendojë se çfarë mund të bëjnë në themelimin e një fondi shtesë për ofrimin e ndihmës për bujqit të cilat janë të dëmtuar si pasoj e kushteve klimatike dhe rendimenteve tepër të ulëta. Pritshmëria ka qenë që në këtë informatë të jepet ndonjë propozim për t'i ndihmuar bujqit sidomos tani kur jemi në prag të mbjelljeve vjeshtore

3. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë, nëntor – dhjetor 2022 dhe janar – shkurt – mars 2023;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se ky raport është hartuar në një formë shumë të mirë si teknike ashtu edhe përmbajtjesore, i njëjti është shumë i pasuruar me të dhëna statistikore dhe shihet se shumë familje dhe biznese janë vizituar ku është bërë konstatimi i saktë i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore. Andaj shpresojmë që Qeveria e Kosovës dhe ajo lokale të mbulojnë kompensimin e këtyre dëmeve në një masë sa më të madhe.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se nuk janë pastruar rrugët dhe lumenjtë nga mbeturinat që kanë ndodhur si pasoj e vërshimeve që janë shkaktuar në muajin korrik e po ashtu nuk është bërë kompensimi i dëmeve materiale për familjet e prekura nga këto vërshimet.

Agim Miftari, zyrtar në DMSH-në cilësinë e kryesuesit të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore paraqiti sqarime duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 33 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, për përuhdën prill-maj-qershor dhe korrik 2023.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në teren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (vërshimet, zjarret dhe erërat e forta) që kanë mbretëruar në periudhën e sipër cekur në Komunën e Vushtrrisë.

3. Komisioni i cekur më lartë ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkulua shumat e mjeteve financiare të shkaktuara dëm në vlerë totale prej **2,125,415.42 €**, si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare dhe biznese këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

6. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi publik me qytetarë;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se ky procesverbal do të kishte pasur kuptim sikur të vjen për aprovim ditën kur është aprovuar buxhetit i komunës, ku do të futeshin edhe kërkesat e parashtruar nga qytetarët e ndryshëm. Më tej duke ju referuar një prononcim të një qytetari në procesverbal ceku se ai ankohet se nuk ka mjek në fshatin Druar, e po ashtu edhe infermieri mungon, nuk ka mirëmbajtje të ambienti të QMF e të ngjashme. Për gjendjen e tmerrshme në mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të mjekësisë duhet të kërkohet përgjegjësi nga menaxhmenti i Ndërmarrjes “Përparimi” të cilët i kushtojnë goxha komunës ndërsa nuk kryejnë punë. Në këtë relacion është mirë që kryetari i komunës t’i sjell para kuvendit faturat dhe raportin për pagesat që janë bërë për Përparimin lidhur me mirëmbajtjen e hapësirave shëndetësore, sepse ai posedon informata se janë ekzekutuar informata pa u kryer punët nga kjo ndërmarrje për këtë destinim.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomike - financiare dhe zbatimin e planeve investuese janar - qershor 2023;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 17 vota “për” 6 vota “kundër”, 1 votë “abstenim” aprovoj Raportin për situatën ekonomike - financiare dhe zbatimin e planeve investuese janar - qershor 2023.

6. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Ismail Qemajli” në Vushtrri;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –vlerësoi se kishte me qenë mirë që për këto pika lidhur me këmbimin e pronës të jepen shpjegime praktike edhe përmes monitorit duke u përcaktuar saktë se ku po bëhet këmbimi i pronës dhe kësaj do ta kishim një pasqyrë reale për këto çështje dhe do të vendosnim shumë më lehtë si kuvend. Për tej kësaj kërkoi nga Drejtoria e Inspektiveve dhe nga vetë kryetari i komunës të dalë në teren dhe të shikoj tek rruga vendi i quajtur tek flamujt, dhe të shikon se si është gjendja ku kompanitë ndërtimore bllokojnë rrugën me materiale ndërtimore zhavorr, beton, armaturë e të ngjashme duke iu shkaktuar kështu një rrëmujë të paparë banorëve të atij lokaliteti ashtu që ata kanë edhe pengesa në qasjen në pronën e tyre.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se e përkrah propozimin e kryetarit të komunës për këmbimin e këtyre pronave dhe shtoj se është ide e qëlluar që vazhdohet me kësi lloj iniciativash që do të krijonin qasje me të mirë e më të kollajshme në rrugë publike si dhe do krijohen hapësira më të mira publike për Qytetin e Vushtrrisë dhe qytetarët e saj.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-u zotua se do t'i vizitoj rrugët kush e sheh se ka pengesa dhe të merret me zgjidhjen e problemeve të qytetarëve, ndërsa lidhur me propozim-vendimet për këmbimin e pronave vlerësoi se është mirë të jepet mundësia që këto rrugë të zgjerohen dhe kështu të kemi një qarkullim më të lehtë për qytetaret tanë, krijim të hapësirave publike dhe shkarkimi të qyteti kjo në një formë edhe mundësohet përmes këtyre këmbimeve të këtyre pronave.

Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimet për këmbimin e pronës mes Komunës së Vushtrrisë dhe bizneseve që janë angazhuar në ndërtimin e banesave kolektive. Ai njoftoi se tek këmbimi i parë kemi 8.05m², ndërsa tek këmbimi i dytë kemi 50.52 m². Pastaj shtoj se në këtë rast janë respektuar të gjitha kondita dhe suazat ligjore, andaj kërkoj që këto propozime të aprovohen.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 19 vota “për” 9 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të “Urban Grup” SH.P.K përfaqësuar nga Fisnik Maloku.

2. Pronat e paluajtshme që do të këmben kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-01094-0,në sipërfaqe prej 8.05 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3441m2 ZK Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me pjesën e parcelës kadastrale P-70202016-06532-0, në sipërfaqe prej 8.05m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2301m² ZK Vushtrri, pronë e “Urban Grup” me seli në Vushtrri.

3. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

4. Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e pronave të paluajtshme pranë Departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe transfereve.

5. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

7. Ku vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Ismail Qemajli” në Vushtri;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 19 vota “për” 10 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të NTP “RIKI” përfaqësuar nga Avni Ferizi.

Organizimi i ceremonisë së varrimit të dëshmorit të Kosovës Afrim Bunjaku, rreshter i policisë i cili u vra në veri të vendit. Në ceremoninë e varrimit të dëshmorit janë kryer pothuajse të gjitha përgatitjet nga ana e DKRS-së, përkatësisht Qendrës së Kulturës, siç janë, Sigurimi i zërimit, i tendave, i karrigeve, i binës e të tjera çështje teknike që janë lidhur me organizimin.

Organizimi i Akademisë Komemorativë të doktor Shukri Gerxhaliut.

Organizimi i përrurimit të librit "Po rritem", të autores Merisa Pushkolli, nxënëse e klasës së shtatë.

Organizimi , i autores Merisa Pushkolli, nxënëse e klasës së shtatë.

Drejtori i QK "Hasan Prishtina" ka qenë edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim të botimeve dhe publikimeve, ku janë mbështetur botime të reja të autorëve vushtrrias, por edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave të tjera për subvencionim, të cilat nuk kalojnë shumë mbi 500 euro, bazuar në rregulloren e MF -së për ndarjen e subvencioneve, si dhe në komisione tjera për vlerësim të projekteve të DKRS-së.

Drejtori i Qendrës së Kulturës, në cilësinë e zyrtarit për informim ka punuar deri më 01 mars 2023, prej kur ka filluar punën zyrtarja për informim e cila është pranuar si punëtore e re.

Drejtori i Qendrës për Kulturë ka marrë pjesë dhe ka qenë anëtarë i komisionit në punëtorinë për hartimin e draft-Rregullores për Kategorizimin e sporteve në Komunën e Vushtrrisë.

Drejtori i Qendrës për Kulturë me propozim të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, dega në Vushtri, është shpërblyer me Mirënjohje me motivacion "për kontributin e dhënë në luftën çlirimtare dhe në institucionet e Republikës së Kosovës". Mirënjohja i është ndarë dhe i është dorëzuar nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, në rastin e Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 Qershor 2023.

Drejtori i Qendrës së Kulturës është i caktuar menaxher i Kontratës për transportin e udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit për Komunën e Vushtrrisë dhe në lidhje me këtë ka proceduar të gjitha kërkesat për transport që kanë ardhur nga drejtoritë, përkatësisht nga zyra e Kryetarit të Komunës.

3. BIBLIOTEKA "NAIM FRASHËRI"

Biblioteka komunale "Naim Frashëri" në Vushtri, detyrat dhe obligimet vjetor i kryen në bazë të planit vjetor, të hartuar në çdo fillim viti.

Të dhënat statistikore për periudhën 1 janar – 30 shtator 2023:

1. Biblioteka amë "Naim Frashëri" ka **38477** libra. Në sektorin e fëmijëve janë **12297** libra ndërsa në sektorin e të rriturve janë **26180** libra.
2. Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim **4132** libra;
3. Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim **2820** libra;
4. Në dy sektorët janë dhënë për lexim **6952** libra;
5. Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar **1033** lexues;
6. Janë përpunuar **560** libra;
7. Lexues të ri të regjistruar **136** vetë;
8. Janë dhuruar nga autorë të ndryshëm **234** libra.
9. Libra të blera: **1318** libra (**296** tituj), me përkrahje financiare nga MKRS-ja

Në sektorin për fëmijë librat më të kërkuara për lexim ishin:

"Lulet e Verës", i autorit Naim Frashëri dhe
"Princesha Argjiro", i autorit Ismail Kadare

Në sektorin për të rritur, librat më të kërkuara për lexim ishin:

"Historia e Skënderbeut" e Marin Barletit.
"Gjenerali i ushtrisë së vdekur" i Ismail Kadaresë

Libri shkencor më i kërkuar për lexim ishte:

Viciana – Vushtrria 1, i Dr.sc. Izet Miftarit

Si zakonisht, stafi i bibliotekës në vazhdimësi është i angazhuar në organizimin e manifestimeve të ndryshme kulturo-artistike, që ndërlihen me data e ngjarje të rëndësishme shtetërore e kombëtarë.

Gjatë periudhës janar – shtator 2023, nga Shërbimi Sprovues i Kosovës – Zyra Rajonale në Mitrovicë, është dërguar dy (2) të mitur delikuent, për të kryer punë të dobishme shoqërore, i dënuar nga gjykata.

Gjatë kësaj periudhe, bibliotekën e kanë vizituar qindra nxënës të shkollave të fshatrave dhe të qytetit të Vushtrrisë.

Me ftesë të Ministrit të MKRS-së, z.Hajrullah Çeku, Udhëheqësi i sektorit të bibliotekës, Dr.sc.Izet Miftari, më 23.02.2022, ka nënshkruar memorandumimin me Ministrin në fjalë për mbështetje financiare të bibliotekës: Pasurim i fondit me libra. Vlera e mbështetjes financiare është **6.451** Euro. Realizimi i memorandumit është bërë më 03.07.2023, me librarinë “Migros 2” në Vushtrri, me që rast janë blerë 1318 libra (296 tituj). Zgjedhja e titujve të librave është bërë sipas kërkesës së lexuesve dhe plan-programit mësimor.

Më 24.03.2023, Udhëheqësi i sektorit të bibliotekës, Dr.sc.Izet Miftari, drejtoresha e DKRS-së, znj. Medina Bunjaku dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z.Dardan Abazi, me rastin e Ditës së Bibliotekës “Naim Frashëri”, u dhuruan libra dy shkollave të komunës së Vushtrrisë: Gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri (81 tituj ose 155 libra) dhe SHFMU “Enver Hadrit” në Smrekonicë (44 tituj ose 96 libra).

Më 20.04.2023, një delegacion nga komuna e Vaxjo ne Suedi, ka vizituar bibliotekën.

Më 01.06.2023, DKRS, në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit, organizoi aktivitet me rreth 100 nxënës të shkollave fillore të komunës së Vushtrrisë, me që rast iu dhuruan nga një libër, me qëllim të vetëdijesimit se leximi i librit, pavarësisht përballjes me botën digjitale dhe internetit, mbetet pazëvendësueshëm.

Është hartuar lista e blerjeve të librave në vlerë 2,000 Euro, të ndara nga Komuna e Vushtrrisë.

4. MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

Raport nëntë-mujor pune nga muzeu për vitin 2023

MUZEU	<ul style="list-style-type: none">• Përgatitja e raporteve javore.• Përgatitja e raportit vjetor për punët e realizuara në muze gjatë vitit 2022.• Përgatitja e raportit gjashtëmujor për punët e realizuara gjatë muajve janar-qershor.• Për qëllim të përsheptimit të procedurave për pranim teknik të objektit të muzeut, përkatësisht monumentit “Shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit, janë realizuar takime me grupin punues për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të ndërtesës “ Shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit” me nr. vendimi 926/2022, ku përpos që janë dhënë vlerësimet lidhur me monumentin në fjalë, janë dhënë edhe rekomandimet për veprimet që duhet të ndërmerren.
--------------	--

Takimet janë mbajtur në objektin e muzeut dhe IKMM (Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve), në përbërje të përfqësuesve të IKMM-së z. Gani Gashi; të QRTK-së znj. Laura Mlinaku Mikullovcit dhe znj. Blerina Bejtullahu; dhe të Komunës së Vushtrrisë z. Nexhat Merovci dhe znj. Shukrane Begu.

- Objekti i Muzeut të Vushtrrisë, përkatësishtë "Monumenti Mahmut Agë Gjinolli" është një nga objektet e përfshira në projektin "EU for All – UE për të gjithë" mbështetur nga Bashkimi Evropian në Kosovë. Projekti ka filluar të implementohet më 8 maj 2023, falë të të cilit do t'ju mundësohet qasje e lehtë të gjithëve, në veçanti personave me nevoja të veçanta.
- Është dorëzuar dokument-përshkrimi i veprimtarisë dhe detyrave të sektorit të muzeut, përbërja stafit ekzistues të muzeut dhe stafi që duhet plotësuar në kuadër të organogramit të komunës, përkatësishtë të sektorit të muzeut i cili funksionon në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Vushtri.
- Është kompletuar dokumentacioni i projektit të planifikuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport: "Rikonstruimi i Muzeut-Shtëpisë të Mahmut Agë Gjinollit", dhe është dorëzuar në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Mitrovicë, për të vazhduar më pastaj me procedurat komunale deri tek implemtimi.
- Lidhur me çështjen e objektit të Muzeut të Vushtrrisë në aspektin e zhvillimit të procedurave të pranimit teknik, janë realizuar takime në kabinetin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sportë, si dhe në kabinetin e Zv.Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, me përfaqësues nga DKRS-ja, Muzeu i Vushtrrisë, MKRS/IKMM-ja, Departamenti i TK-së, QRTK-ja, MAPL-ja, DU-ja, etj!
- Pas kërkesave të dërguara në Qendrën për Trashëgimi Kulturore në Mitrovicë, për tu pajisur me pëlqim për impementimin e projektit: "EU-for All" në objektin e muzeut, përkrahur dhe financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian; si dhe projektit:

	<p>“Rikonstruktimi i Muzeut Mahmut Agë Gjinolli”, të planifikuar dhe financuar nga Komuna e Vushtrrisë, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, më 02.10.2023 janë lëshuar vendimet e pëlqimeve të nxjerra nga IKMM-ja, nëpërmes QRTK-së për implementimin e projekteve në objektin e muzeut.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafi i muzut ka punuar intenzivisht në risistemimin dhe pastrimin e koleksioneve të muzeut, të cilat ishin zhvendosur nga persona të panjohur gjatë aktit të hyrjes me dhunë në objektin e muzeut. Prandaj është më se e nevojshme që sa më parë të sigurohet objekti i muzeut duke vendosur kamera, alarm dhe roje!
<p>PUNËT HULUMTUESE DHE IDENTIFIKIMET</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Në kuadër të punëve hulumtuese në terren janë identifikuar dhjetra e qindra eksponate të ndryshme nga fusha e etnologjisë të punuara me motive gjeometrike e florale. Eksponatat janë identifikuar në familjet: Kuqani, Bunjaku, Gjaka, Mehmeti, Jetullahu, Ispahiu, Qerkezi, Mikushnica, Tiriqi, Merovci, Bytyqi, etj. • Gjithashtu është vazhduar me punën hulumtuese në deponitë e metalit në Vushtri, ku shpeshherë dërgohen eksponate shumë të rëndësishme nga metali në këmbim të të hollave minimale.
<p>PASURIMI I SEKTORËVE: ARKEOLOGJI HISTORI ETNOGRAFI TEKNOLOGJI FOLKLOR DHE KULTURË SHPIRTËRORE</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Muzeu u pasurua me mbi 40 (dyzet) ekspozante nga materiale të ndryshme të dhuruara nga Nermin Tiriqi Merovci, dhe Rexhep Bytyqi, siq janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Semaver çaji nga materiali i bakrit mbi 120 vite i vjetër; ▪ Goblen, pikturë muri e punuar me dorë në vitet e 70-ta; ▪ Xhezve për kafe nga materiali i bakrit rreth 50 vite i vjetër; ▪ Jakë nga gëzofi i dhelprës, e cila vendosej mbi palltë, mode e zonjave të viteve të 70-ta; ▪ Jakë nga gëzofi i dy kafshëve të vogla, e cila vendosej mbi kostume si aksesuare, po ashtu pjesë e

	<p>vejshjeve modern e veteve të 70-ta;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Jakë nga gëzofi i bizonit, e cila perdorej gjatë mbremjeve festive të viteve të 70-ta dhe 80-ta; ▪ Vazo bakri të viteve te 70-ta; ▪ Ekspozitat epo objekt për matjen e temperaturës dhe vendosjen e lapsave e viteve te 80-ta. ▪ Semaver elektrik; ▪ Dy llampa shumë të veçanta të dekoruara me motive florale, mbi 60 vite të vjetra; ▪ Goblen muri (pikturë) me motive florale, e punuar dhe e qëndisur me dorë. <ul style="list-style-type: none"> • Gjithashtu, muzeu u pasurua me dhjetra ekspozita etnologjike të dhuruara nga pronari i hekurishtës Tiriqi z.Jakup Tiriqi. Ekspozitat në fjalë janë identifikuar kohë më parë nga stafi i muzeut gjatë punëve në terren.
<p>PASURIMI I SEKTORIT TË KINOTEKËS DHE FOTOTEKËS</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Muzeu- sektori i fototekës u pasurua me 33 fotografi të vjetra familjare të Vushtrrisë, të realizuara kryesisht në fund të shek.XIX dhe fillim të shek.XX.
<p>BIBLOTEKA SHKENCORE E MUZEUT</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Biblioteka e muzeut ka gjithësejtë 416 libra, kryesisht shkencorë. Në kuadër të bibliotekës është punuar me studentë dhe lexues, duke ju ofruar shënime dhe literaturë shkencore në realizimin e detyrave dhe punimeve shkencore.
<p>INVENTRIZIMI DIGJITAL I EKSPONATEVE HISTORIKE, ARKEOLOGJIKE, ETNOGRAFIKE FOLKLORIKE</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Në muze u inventarizuan gjithsejtë 58 ekspozita nga kultura materiale: <ul style="list-style-type: none"> ➤ 47 nga sektori i etnologjisë; ➤ 8 nga sektori i teknologjisë; ➤ 3 nga sektori i arkeologjisë.
<p>AKTIVITETET E MUZEUT</p>	<p>Edhe gjatë vitit 2023 muzeu organizoi aktivitete të cilat kishin për qëllim promovimin, edukimin dhe vetëdijësimin e gjeneratave të reja përmes komunikimit muzeor.</p>

- Mbështetur nga kyetari i komunës dhe drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, stafi i muzeut në bashkëpunim me ansamblin "Hasan Prishtina", shënuan "Ditën Ndërkombëtare të Autizmit". Aktiviteti u realizua me fëmijët e prekur nga autizmi dhe sindrom down duke pikturuar dhe duke vallëzuar në mini-koncertin e shfaqur nga ansambli i qytetit.
- Muzeu i Vushtrrisë së bashku me Klubin e hendbollit të vajzave të Vushtrrisë dhe Vushtrria Guide përfaqësuan Komunën e Vushtrrisë dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në "Panairin Ndërkombëtar të Turizmit dhe Sportit" të organizuar më 27-28 prill, në sallën 1 tetori në Prishtinë, ku u prezantuan pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Vushtrrisë, si dhe arritjet në fushën e sportit.
- Për nder të "Ditës Ndërkombëtare të Muzeut" më 18 maj, brenda hapsirave Muzeut të Vushtrrisë është realizuar aktivitet me nxënës të moshave të ndryshme, ku është diskutuar për rëndësinë dhe rolin e muzeve në ruajtjen dhe prezantimin e kulturës materiale e shpirtërore.
- 1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve u shënuar në Muzeun e Vushtrrisë së bashku me nxënësit dhe mësimdhënësit e "Shkollës fillore të mesme të ulët Migjeni" nga Stanoci i Epërm me një aktivitet edukativo – arsimorë, duke realizuar vizita në ambientet e muzeut dhe kalasë së vjetër të qytetit.
- Muzeu i Vushtrrisë festoi "Ditën e Muzeut", përkatësisht përvjetorin e themelimit të Muzeut të Vushtrrisë më 09.06.2023, me aktivitetin e quajtur "një kujtim nga muzeu". Aktiviteti u zhvillua me nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore Mustafë Venhari, të cilët përpos që mësuan për muzeun dhe vlerat që ka, atyre iu mundësua realizimi i fotografive me elemente tradicionale duke iu krijuar kujtime nga muzeu.
- Si çdo here, stafi i muzeut rëndësi të veçantë iu ka kushtuar nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, në realizimin e vizitave edukative e mësimore në Muzeun e Vushtrrisë / në monumentin "Mahmut agë Gjinolli", si dhe në monumentet e

trashëgimisë kulturore në Vushtri.

- Muzeu gjithashtu ka vazhduar punën duke realizuar vizita në shkolla të zonave rurale të Komunës së Vushtrisë për qëllim të hulumtimit të pasurive muzeore, por edhe për të ligjëruar në kuadër të procesit mësimor tek lënda shoqëria dhe mjedisi. Ligjëratat kishin për qëllim prezantimin e pasurive të Muzeut të Vushtrisë dhe trashëgimisë kulturore, si dhe vazhdimin e bashkëpunimit me nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave.
- Gjatë muajve të diasporës muzeu priti mërgimtar nga diaspora, të cilët u informuan me pasuritë e muzeut dhe historikun e objektit të Mahmut Agë Gjinollit.
- Në kuadër të manifestimit tradicional "Ditët e Diasporës" (pjesa e dytë), më 24 gushtë stafi i muzeut improvizoi odën tradicionale me ekspozate tradicionale të muzeut, për të vazhduar me kulturën folklorike muzikore të organizuar nga Ansambli i këngëve dhe valleve Hasan Prishtina".
- Muzeu priti dhe shoqëroi grupe me nevoja të veçanta nga Handy-Kos Prishtina, me të cilët vizituan qytetin e Vushtrisë dhe disa nga monumentet e trashëgimisë kulturore.
- Në kuadër të javës Evropiane për Trashëgimi Kulturore është realizuar takim ndërmuzeal me muzetë e Kosovës, ku u diskutua për të ardhmën e muzeve lokal të Kosovës, vështirësitë e veprimarisë muzeale, mundësitë për rrjetëzim të muzeve, etj.

5. SEKTORI I RINISË

Aktivite

Përgaditja e planit të punës për sektorin e Rinisë për vitin 2023.

Së bashkë me Qendren Rinore, bordin e KVRL-së dhe grupet joformale u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2023, po ashtu u bë edhe ristrukturimi i këtij këshilli.

Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ-ve rinore gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dhe janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkpunim me OSCE, ku janë plotësuar disa pyetsor që janë dërguar nga ta edhe njëher OSCE ka shpreh gatishmëri që të bashkëpunojë në aktivitete të ndryshme në fushat të cilat mund të na ndihmojë OSCE-ja.

Qendra Rinore "Hareja" ka mbajtur trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për të gra dhe vajza të grupmohave të ndryshme, në fund të këtyre trajnimeve pjesmarrsëve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve. Ky projekt është mbështetur nga IOM dhe është asistuar nga sektori i rinisë.

Janë njoftuar të gjitha OJQ-të rinore, KVRL-ja, Qendra Rinore si dhe grupet jo formale të rinjëve për thirrjen publike për mbështetje financiare nga Komuna, po ashtu janë njoftuar edhe për thirrjet nga MKRS-ja, njëherit do të ofrohet mbështetje aq sa do të jetë e mundur në kapacitetet tona.

Takime me kryetarën e KVRL-së, në këto takime u planifikua për projektet që parasheh të organizoj KVRL, po ashtu diskutua për sfidat dhe problemet që ka KVRL e një ndër to edhe hapja e llogaris nga KVRL si dhe qështje të ndryshme rreth KVRL-së.

Organizata Rinore "Aces" në bashkpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojn trajnime për të rinjët në komunën e vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Takime pune me përfaqësuesit e The Power of Mind dhe KVRL'së ata kan hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal, Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhëshme.

Takim me përfaqësuesin e OJQ "Levizja Koha" me të u diskutua për projektet që parasheh të realizojë kjo OJQ, për formen e aplikimit dhe qasje ne fonde te donator të ndryshëm.

Është në realizim e sipër projekti "Komuna për të Rinjët" ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë në bashkpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore si dhe organizatës facilituese CDF. Ky projekt do të ketë një impakt të mire për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shuma totale për mbështetjen e të rinjëve në total arrin vlerën 250'000.00 dollar amerikan.

KVRL në bashkpunim me organizaten "Domain for Kosovo" kan mbajtur sesion informues për të rinjët në shkollat e mesme, ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjëve për themelimin dhe punën e KVRL-së si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

Trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore "Hareja" e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar

Punë dhe takime të ndryshme me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve rinore.

6. SEKTORI I SPORTIT

Aktiviteti	Gjithsejt	Me pagesë	Pa pagesë
Stërvitje	2579		
Ndeshje	279		
Rekreacion	144		

7.

Numër rendor	Emri I shfrytëzuesit tëPalestrës	Stërvitje		Ndeshje		Rekreacion	
		Me pagesë	Pa pagesë	Me pagesë	Pa pagesë	Me pagesë	Pa pagesë
1	Kl.iBoksitKALAJA		108				
2	Kl.iBoksit VUSHTRRIA		108				
3	Kl.iBasketbollit VU BASKET		355		72		
4	Kl.iBasketbollit VUSHTRRIA-F		144		12		
5	Kl.iBasketbollit VUSHTRRIA-M		144		15		
6	Kl.iGjmnastikës VUSHTRRIA		216				
7	Kl.iHendbollit VUSHTRRIA-F		144		36		
8	Kl.iHendbollit VUSHTRRIA-M		144		36		
9	Kl.iHendbollit SAMADREXHA-F						
10	Kl.iHendbollit SAMADREXHA-M						
11	Kl.iVolejbollit VUSHTRRIA-F		180		36		
13	Kl.iVolejbollitAS VUSHTRRIA-M		144		36		
14	Kl.iVolejbollit AS VUSHTRRIA-F		144		36		
15	Kl.iPingpongut H.PRISHTINA		216				
16	Kl.iPingpongut VUSHTRRIA		216				
17	Kl.iXhudos VICIANUM		108				
19	Kl.iMundjes KOSOVA		64				
22	Gzim Sokoli						
25	Shoqata e tëShurdhërve		36				
27	Agron Neziri						
28	Besart Muja						
29	Kl.iBasketbollit GJIMNAZISTI		36				
30	KXH Studenti		72				
31							
	TOTALI		2579		279		144

8. ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik është institucion i cili pranon , evidencon, rregullon dhe publikon lëndën arkivore, mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet,organizatat, institucionet, personat civil-juridik.

Arkivi kryen veprimtarinë konform ligjit dhe akteve të përgjithshme juridike, ky institucion punët i kryen nëpërmjet këtyre shërbimeve:

- **Shërbimi për mbrojtjen e lëndës arkivore brenda dhe jashtë arkivit**
- **Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale**
- **Evidentimi dhe rregullimi dhe klasifikimi i dokumenteve arkivore brenda arkivit**
- **Aktivitete tjera**
- **Punët e udhëheqjes në arkiv**
- **Aftësimi profesional i punëtorëve**

Arkivi Historik i Qytetit-Vushtrri

<p>Shërbimi për mbrojtjen e dokumenteve arkivore jashtë arkivit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kemi pasur konsultime dhe komunikime të ndryshme me njësitë të cilat krijojnë dokumente në kuadër të regjistraturës komunale.
<p>Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ne periudhën mars qershor në bashkpunim me Drejtorinë e Administratës Komuna Vushtrri kemi transportuar materialin e disa drejtorive nga depoja e Arkivit të brendshëm të Komunës në objektin e Arkivit të Qytetit duke përfshirë: • Dokumente nga Drejtoria e Administratës, Bujqësisë, Urbanizmit, Prokurimit. Dokumentacioni është vendosur në depon e Arkivit në ormane metalike , i pasistemuar me përjashtim të Drejtorisë së administratës.
<p>Evidentimi rregullimi dhe klasifikimi dokumenteve brenda arkivit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Gjatë kësaj periudhe kemi bërë sistemimin klasik të dokumentacionit Brenda kushteve dhe mundësive të cilat I posedon Arkivi . egziston edhe një pjesë e dokumentacionit në gjendje jo të mirë në mungesë ta rafteve arkivore. • Dokumentacioni I Drejtorisë së Administratës është klasifikuar, sistemuar dhe i vendosur në ormane metalike nga stafi I drejtorisë përkatëse. • Në bazë të ligjit dhe marrëveshjes me Drejtorinë e Adm,inistratës e cila ka qenë përgjegjëse për mënyrën e bartjes dhe dhe transportit.
<p>Aktivitete tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Si njësi arkivore dhe si staf zyrtar kemi bashkëpunuar me DKRS dhe fushat tjera të Kuvendit komunal Vushtrri, duke përfshirë edhe komisionet e ndryshme të caktuara me vendim të kryetarit të Komunës. • Në bashkpunim me DKRS kemi pasur edhe një prezertim të dokumenteve arkivore për grupin punues nga qyteti VAXJO-Suedisë. Ky prezentim ka qenë në kuadër të projektit për digjitalizimin e dokumenteve arkivore. Në kuadër të këtij projekti përfshihet edhe vizita në qytetin e VAXJO , ku pjesë e grupit punues është edhe udhëheqësi i Arkivit.
<p>Punët e udhëheqjes në Arkiv</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Arkivi Historik i qytetit menaxhohet nga udhëheqësi dhe stafi i Arkivit në bashkëpunim me DKRS-Vushtrri. • Në arkivin e qytetit janë dy vende të lira si ndihmësarkivist ,

	kështu që edhe kjo dukuri e pengon punën ekipore e cila duhet të zhvillohet në Arkiv.
Aftësimi profesional i punëtorëve	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë këtij viti të punës sa përket aftësimit profesional nuk ka pasur trajnime në drejtim të lëndës së Arkivistikës si lëmi përkatëse për arkiv.

9. TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Si Teatër i Qytetit "Adem Mikullovcit" kemi arritur që të realizojmë disa shfaqje për vitin 2023 janar-qershor kemi realizuar :

Shfaqjen Ariu të autorit Çehovë

<https://www.koha.com/premiera-shfaqjes-ariu-çehovit-me-17-prill-ne-uzurbayce>
<https://www.koha.com/shfaqja-ariu-çehovit-17-prill-ne-uzurbayce>

<https://www.koha.com/shfaqjen-mund-ta-ndiqni-ne-kete-link> Shfaqjen mund ta ndiqni në këtë link

Shfaqje që u mirëprit nga publiku me 27 prill 2023 ishte premiera e kësaj shfaqje dhe në linkun më lartë është edhe kritika për shfaqjen .

Teatri ka pasur angazhime më 16 shkurt është shfaqur shfaqja për fëmijë " Tomi dhe Xheri " ishin fëmijët që ju gëzuan kësaj shfaqje

Ne kemi filluar realizimin e shfaqjes për fëmijë "Panda në udhëtim" në muajin mars 2023 mirpo për shkak të angazhimeve të shumta në sallën e teatrit me manifestime të ndryshme ne këtë shfaqje për fëmijë do ta vazhdojmë nga muaji shtator

Ndërsa tani ne kemi filluar përgatitjen e shfaqjes " Çfarë ka parë shërbëtori "dhe presim nga muaji shtator-tetor të dalim me premierë. Teatri edhe me statut e ka që Brenda vitit ti realizoj tri shfaqje por çdo herë duke e ditur se shfaqjet duhet të përkrahen nga komuna e Vushtrrisë .

Teatri është angazhuar edhe në manifestimet tjera që janë organizuar edhe nga DKRS ,si tani në manifestimin e ditëve të diasporas.

Ne po shpresojmë që vitin ta mbyllim me tri premiera

"Ariu " Premiera është dhënë me 27 prill 2023

" Panda në udhëtim " muaji shtator- tetor 2023 presim si premierë

" Çfarë ka parë shërbëtori " Shtator 2023 presim premiere

Përgjegjës i Teatrit – Fazli Muharremi

10.ZYRTAR PËR KULTURË

Gjatë kësaj periudhe, duke u bazuar edhe në kalendarin e aktiviteteve që kemi në DKRS, jam angazhuar në organizimin e "Ditës së Pavarësisë" së Kosovës me 17 shkurt, "Epopenë e UÇK-së" 6 mars, si dhe organizimet dhe akademitë përkujtimore të cilat organizohen nga DKRS.

Në muajin prill bashkë me arkitektët Z.Bujar Demjaha dhe Z.Arbër Shita, kemi bërë përnjohjen e fshatit Skoçën. Kemi monitoruar fshatin dhe disa shtëpive u është bërë matja e tyre. Ideja është për një projekt i cili ka të bëjë me "rigjenerimin e fshatit" turizmin kulturor dhe rural.

Kam marr pjesë nëpër disa komisione si; për vlerësim të ofertave, pranim malli, etj. Po ashtu edhe përgatitjen e specifikacioneve për nevojat e DKRS-së.

Si kryesues i komisionit për identifikimin e masakrave në komunën e Vushtrrisë (1998 -1999), bashkë me anëtarët e tjerë të këtij komisioni kemi identifikuar se sa masakra kanë ndodhur në Komunën e Vushtrrisë.

Kam monitoruar gjendjen e objekteve të trashëgimisë kulturore si; Kalanë e Vjetër, Urën e Gurit, Hamamin, Shtëpinë e Zejnullah Begut në fshatin Balincë, Kullën e Azem Bejtës në fshatin Galicë, "ansamblin" e shtëpive në fshatin Gumnishtë, lokalitetet arkeologjike si; Strofc, Dubovc, Samadrexhë, Druar, Smrekonicë dhe Gojbulë.

Bashkë me një ekipë nga UP "Hasan Prishtina" I përbër nga profesorët dr. Arben Hajdari, Premtim Alaj dhe profesori I arkeologjisë dr. Christof Doer nga Franca kemi ri lexuar (rideshifruar) mbishkrimet romake në Komunën e Vushtrrisë. Për here të parë është deshifruar një altar romak I cili gjendet brenda objektit të kishës "Shë Ilija" në Vushtri. Ai altar deri më sot nuk ka mundur të studiohet për arsye se kisha e ka përvetësuar dhe është munduar ta tjetërsoj me ndërhyrje duke e lyer me ngjyrë të bardh për t'ia fsheh mbishkrimet!

Kemi monitoruar edhe një aneks I cili është ndërtuar në oborrin e kishës së Bajskës në Vushtri. Monitorimin e kemi bërë bashkë me drejtoreshën e QRTK-së në Mitrovicë.

Bashkë me Luan Gashin arkeolog nga Instituti i Arkeologjik i Kosovës dhe me profesorin nga Gjermania Prof. Dr. Harald Floss, kemi qenë në përnjohje të terrenit në lokalitetin "Gomure" të fshatit Samadrexhë për të kërkuar e hulumtuar lëndën e parë të "Strallit" material organik me të cilin para mijëra vitesh, ose më mire të themi në "epokën e neolitit" kanë prodhuar vegla pune, armë të ndryshme,(shigjeta, thika, sëpata etj) nga kjo lëndë. E rëndësishmja e këtij lokaliteti ishte se për here të parë u bë një hulumtim I tillë ku u zbulua se po në këtë vend (Gomure) është marrë lënda e parë.

Jam angazhuar që të organizohet "tryezë shkencore" për nderë të shënimit të datës 30 qershor 1912 ku është ngritë flamuri kombëtar në fshatin Vesekovc, bashkë me profesorët nga UP "Hasan Prishtina" si; Prof. Mentor Hasani dhe Prof. Dorajet Imeri kemi bashkë – organizuar këtë ngjarje historike. Në këtë tryezë shkencore kanë marr pjesë profesorë dhe figura të njohura nga Kosova por edhe akademikët nga Shqipëria z. Marenglen Verli dhe z. Beqir Metaj, e që ky organizim është mbajtur nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi. Për këtë organizim fillimisht ka qenë ideja që të bëhet bashkë me Komunën e Mitrovicës, por me gjasë nuk gjetën përkrahje disa individë (nga Mitrovica) të cilët në fund u tërhoqën. Organizimi ishte në nivel, e sipas udhëheqësve të tryezës gati sa u bë "Konferencë Shkencore".

Kam trajtuar të gjitha kërkesat e Intranetit që vijnë në DKRS. Kam kryer edhe pune të tjera administrative sipas kërkesave dhe detyrave që mi ka dhënë eprorja ime.

Iu dërgohet:

- I x Kryetarit të Komunës
- I x Arkivit të DKRS-së



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

KOMISIONI VLERËSUES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE PËR OJQ-të

Bazuar në nenin 8, pika 1, neni 20 pika 1 të Rregullores së Ministrisë së Financave nr- 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për Kulturë, Rini dhe Sport, në bazë thirrjes publike të datës 27.03.2023, si dhe bazuar në vendimin e kryetarit të komunës nr-545/23, të datës 05.05.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues për ndarjen e subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe në bazë të vendimit për rivlerësim, nr. 34648/23, të datës 25.07.2023, të lëshuar nga Komisioni për Ankesa, Komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve mori këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Vushtrrisë

1. Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport subvencionet ndahen si vijon:

Nr. rendor	PËRFITUESI	Shuma	Vërejtje
2.1	K.HENDBOLLIT-VUSHTRRIA-F	7.500.00	
2.2	K.HENDB.VUSHTRRIA -M	7.500.00	
2.3	KLUBI I BOKSIT- KALAJA	600.00	
2.4	K.HENDB.SAMADREXHA -F	6000.00	
2.5	K.HENDB. SAMADREXHA-M	2000.00	
2.6	SHOQATA E PEDAGOGËVE	800.00	
2.7	SHOQATA SITNICA	2000.00	
2.8	K.BOKSIT VUSHTRRIA	800.00	
2.9	EVDS	1000.00	

2.10	K.VOLEJB. AS VUSHTRRIA- F	1000.00	
2.11	K.VOLEJB..AS VUSHTRRIA -M	1000.00	
2.12	K.GJIMNASTIKËS VUSHTRRIA	3000.00	
2.13	K.FUTB..VETERANËT VUSHTRRI	600.00	
2.14	KLUBI I BASKETBOLLIT VUSHTRRIA-M	5000.00	
2.15	K.PINGP.VUSHTRRIA -M	2000.00	
2.16	K.PINGP.VUSHTRRIA-F	2000.00	
2.17	K.VOLEJBOLLIT.VUSHTRRIA -F	1500.00	
2.18	FUTSALL	3000.00	
2.19	SHOQATA E SHURDHËVE	600.00	
2.20	SHOQATA DRITA JONË	1500.00	
2.21	OJQ "HAREJA"	1500.00	
2.22	OJQ "SZHBD"	700.00	
2.23	OJQ "ORDA"	1500.00	
2.24	OJQ "PHOENIX"-VUSHTRRI	1000.00	
2.25	L'ART GALERY	5000.00	
2.26	OJQ "ISKAN"	1000.00	
2.27	OJQ "VITRINA"	2500.00	
2.28	OJQ "BIODIVERSITETI"	800.00	
2.29	OJQ ASSK	500.00	
2.30	OJQ PROGRESI	500.00	
2.31	OJQ KOMUNALE PENSIONIST INVALIDOR	500.00	
2.32	URA SOCIALE	500.00	
2.33	KLUBI KIKBOKSIT- VUSHTRRIA	2000.00	
2.34	KLUBI PING PONGUT HASAN PRISHTINA	1000.00	
2.35	SHKOLLA E TENISIT	800.00	
			Total: 69,200.00.€

Nr. rendor	LISTA E PROJEKTEVE TË REFUZUARA	Shuma	Vërejtje
2.1	FUTBOLL KLUB FORCA	refuzohet	
2.2	K.BASKETB. VUSHTRRIA BASKET	refuzohet	
2.3	FC.EL-CLASICO	refuzohet	
2.4	VICIANA VIZION	refuzohet	
2.5	SHOQATA KULTURORE GJURMËT	refuzohet	
2.6	OJQ VICIANA 2019	refuzohet	
2.7	CREATIV CENTER	refuzohet	
2.8	KLUBI I BASKETB.GJIMNAZISTI-VUSHTRRIA	refuzohet	
2.9	OJQ "KATUNI I MOQËM"	refuzohet	
2.10	OJQ INSTITUTI PR STUDIME EVROPIANE	refuzohet	
2.11	OJQ ACCES	refuzohet	
2.12	THE POWER OF MIND	refuzohet	
2.13	MIMOZA HASANI	refuzohet	
2.14	QENDRA PSIKO SOCIALE DHE MJEKSORE	refuzohet	
2.15	PASIONI RINOR	refuzohet	
2.16	ART NATYRA	refuzohet	
2.17	OJQ VARG E VII	refuzohet	

Këshillë juridike: Palët e pakënaqura me këtë vendim kanë të drejtë të paraqesin ankesë në komisionin për ankesa, në afatin prej 5 ditësh nga dita e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të komunës.

Vushtrri, 04.08.2023

Komisioni vlerësues:

1. Xhevrije Rama kryesuese
2. Ekrem Miftari anëtar
3. Qemajl Hasani anëtar
4. Lavdim Feka anëtar
5. Leonita Osmani anëtare





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI



Për,
Propozues,
Hartues,
Çështja për shqyrtim, propozim-vendim

KPF dhe Kuvendin e Komunës
Kryetari i Komunës
Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 5 paragrafi 9 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrjen e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2023 merr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJE TË MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE
“PËRPARIMI” SH.A NË VUSHTRRI

1. Me këtë vendim, ndahen mjete financiare nga buxheti i komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2023, në shumë të përgjithshme prej 60,000.00 € (gjashtëdhjetëmijë euro) për N.P.L “Përparimi” Sh.a. në Vushtrri (mbështetje financiare) për blerje të mjeteve të punës – Kamion për bartje të mbeturinave (Kompaktor), kontejnerë etj.
2. Mjetet në shumën e cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen si vijon:
 - 2.1 Nga buxheti i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, 40,000.00 € (dhjetëmijë euro), kodi..., subvencione dhe transfere
 - 2.2 Nga buxheti i Drejtorisë për Arsim, 20,000.00 € (njëzetmijë euro), kodi..., subvencione dhe transfere.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Ky vendimi hyn në Fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Nga NPL "Përparimi" në Vushtrri kemi pranuar kërkesë për mbështetje financiare për blerje të mjeteve të punës – pajisjeve për mbledhje dhe bartje të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë pasi që kjo ndërmarrje tani ka siguruar lejen në Ministrinë e linjës për operim në mbledhjen dhe transportin e mbeturinave. Për të ushtruar me sukses këtë veprimtari krahas shërbimeve tjera që i kryen, nevojiten mjete të punës – kompaktor, kamion dhe mjete tjera të punës të cilat nuk ka mundësi që të sigurohen me buxhetin e kësaj ndërmarrje.

Konsiderojmë se kjo kërkesë është e arsyeshme dhe duhet të mbështetet, andaj i propozojmë Kuvendit të komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.

Në shtojcë është bashkëngjitur kërkesa e NPL "Përparimi" në Vushtrri.



NGA/OD/FROM:		Fadil Bahtiri – Kryeshef Ekzekutiv në N.P.L "Përparimi" Sh. A		
PËR/ZA/TO:		Ferit Idrizi – Kryetar i Komunës së Vushtrrisë		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Kërkesë për mbështetje financiare për blerjen e mjeteve të punës, kamionë për mbledhje dhe transportim të mbeturinave		
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Nr. 1	Lokacioni: Kucni: Location:	Rr. Gjergj Kastriot Skënderbeu nr. 82, pranë gjykatës, ish objekti i TMK-së.	Data: 25.09.2023 Datum: Date:

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenit 6 nën pika 1.3.2 dhe neni 26 të Statutit Nr. 252/22 të N.P.L "Përparimi" Sh. A, në bazë të rregullores 35/23, neni 16 pika 1.10, në bazë të njoftimit nr. 7763-2/22 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e në bazë të Vendimit Nr. 08Nr. 64/2023 të datës 10.02.2023 për lëshimin e lejes mjedisore komunale, po ju drejtohem me:

KËRKESË

(Për mbështetje financiare për blerjen e mjeteve të punës kamionë për mbledhje dhe transportim të mbeturinave)

I nderuar Kryetar i Komunës shpresoj se je mirë me shëndet, dhe punët po të ecin mbarë. Si Kryeshef Ekzekutiv në N.P.L "Përparimi" Sh. A, dua të ju njoftoj se ndërmarrja ka bërë përgatitjet e saja administrative (Miratimi i statutit të ri, shtimi i aktivitetit të grumbullimit të mbeturinave në ARBK, pajisja me leje mjedisore për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale, lidhja e marrëveshjes për shfrytëzimin e deponisë në "Gërmova" për deponim të mbeturinave me KRM "Uniteti" Sh. A, shtimi i njësisë së mbledhjes së mbeturinave në kuadër të rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, draftimi i Planit Operativ për mbledhjen e mbeturinave).

Ndërsa në aspektin e operimit, kemi nevojë për mbështetje financiare nga ana juaj, për blerjen e disa mjeteve të punës dhe kamionë për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave në komunën e Vushtrrisë.

Ne si ndërmarrje kemi nevojë që të furnizohemi me kamionë dhe mjete të ndryshme pune si në tabelën më poshtë:

Nr.	Lloji i mjeteve të punës	Sasia	Totali
1.	Kompaktor (kamion) për mbledhje të mbeturinave	5	
2.	Kamionë për mbeturina 7 m ³	2	
3.	Kontejnerë 1.1 m ³	50	
4.	Vetura për mbikëqyrje të terrenit	2	
5.	Vetura – Cady (pikap) për bartje të materialit të punës	2	
6.	Vlera e parashikuar për mbështetje financiare		295,000 euro

Fadil Bahtiri
Kryeshef Ekzekutiv në N.P.L
Përparimi Sh. A





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtri



Për: Kuvendin Komunal

Propozues: Kryetari i Komunës, z. Ferit Idrizi

Hartues: Drejtoria e Arsimit, drejtori z. Dardan Abazi

Lënda: Propozim – vendim për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë.

Bazuar në nenin 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 , nenit 35 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032. Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, dhe Nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më, _____ miraton këtë :

V E N D I M

**PËR EMËRIM TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE
DHE ZËVENDËSDREJTORËVE NË KOMUNEN E VUSHTRRISE**

1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:
 - 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së
 - 1.2. Visar Sadriu, drejtor i SHFMU" Andon Zako Çajupi" Vushtri
 - 1.3. _____, përfaqësues i MASHT-it
2. Komisioni do t'i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar.
3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat për një vit shkollor.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartcekur.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesja e Kuvendit


Melihate Basholli Latifi

A r s y e t i m

Me qenë se anëtarëve të më parshëm të Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese i ka skaduar mandati, Drejtoria Komunale e Arsimit kërkon nga Kuvendi Komunal që sa më parë që është e mundur të bëhet emërimi i Komisionit të ri për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve në institucionet edukativo-arsimor dhe aftësues, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.151/2020.

Me respekt!




Dardan Abazi
Drejtori i DKA-së